

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI I FILOLOGJISË



MA ADELINË SELMANI

PASTHIRRMA DHE ONOMATOPEJA – BAZAT MOTIVUESE DHE ROLI I TYRE  
NË FJALËFORMIMIN E SHQIPES

**PUNIM I DOKTORATËS**

Prishtinë, 2024

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI I FILOLOGJISË



MA ADELINË SELMANI

PASTHIRRMA DHE ONOMATOPEJA – BAZAT MOTIVUESE DHE ROLI I TYRE  
NË FJALËFORMIMIN E SHQIPES

**PUNIM I DOKTORATËS**

Mentor: Prof. dr. Rrahman Paçarizi

Prishtinë, 2024

UNIVERSITY OF PRISHTINA “HASAN PRISHTINA”

FACULTY OF PHILOLOGY



MA ADELINË SELMANI

INTERJECTION AND ONOMATOPOEIA – MOTIVATION BASIS AND THEIR  
ROLE IN ALBANIAN WORD-FORMATION

**DOCTORAL THESIS**

Mentor: Prof. dr. Rrahman Paçarizi

Prishtinë, 2024

## Rezyme

Punimi doktoral *Onomatopeja dhe pasthirrma – bazat motivuese dhe roli i tyre në fjalëformimin e shqipes* është studim analitik, empirik dhe komparativ që diktohet nga natyra e hulumtimit të këtyre dy pjesëve të ligjëratës, të cilat, edhe pse janë parë si të ndërlidhura, zënë vende tërësisht të veçanta në ligjëratë, kryejnë funksione të ndryshme në fjali dhe kanë origjinë të ndryshme. Punimi është i ndarë në tetë kapituj, që nisin me analizën përgjithësuese teorike; përkufizimin e onomatopesë dhe pasthirmës, trajtimin e strukturës fonetike-fonologjike, morfologjike, fjalëformuese dhe të funksioneve gjuhësore; vendin e tyre në letërsi, për t'u përmbyllur me një sprovë për rikategorizim të onomatopeve dhe të pasthirmave. Studimi, që përfshin metoda të ndryshme për testimin e hipotezave initiale, udhëhiqet nga parimi analizues, konkretizues dhe synon të shpërfaqë formimin dhe përdorimin e këtyre pjesëve të ligjëratës.

**Në kapitullin e parë**, *Sfondi historiko-teorik*, përmes një vështrimi gjeneralizues, trajtohet origjina e gjuhës, gjuha si shenjë, imitimi i tingujve, arbitrariteti i shenjës gjuhësore e aspekte të tjera. Sfondi teorik ndihmon për thellimin studimor të onomatopeve dhe të pasthirmave, të cilat, në gjuhësinë shqiptare, kanë mbetur si një nga pjesët më të margjinalizuara të ligjëratës. Pas analizës së sfondit teorik, në mënyrë gjeneralizuese, **në kapitullin e dytë** jepen përkufizimet e pasthirmës dhe onomatopesë, duke vënë në pah tiparet më reprezentative të tyre, të përbashkëtat dhe dallimet. Gjithashtu, në këtë kapitull analizohen tekstet teorike-studimore, për të kaluar tek analiza që u është bërë në gjuhësinë shqiptare onomatopeve dhe pasthirmave, veçanërisht në gramatikat shkollore, normative, si dhe është bërë komentim i këtyre teksteve me qëllim të paraqitjes së një sprove për kategorizimin dhe ndarjen e tyre. Një analizë e tillë shërben për ta paraqitur të plotë panoramën studimore të këtyre pjesëve të ligjëratës dhe njëkohësisht ballafaqon këndvështrimet e gjuhëtarëve të ndryshëm për fenomene të njëjta dhe përcakton rrjedhën e mëtutjeshme të punimit.

**Kapitulli i tretë**, “Semantika e pasthirmave dhe e onomatopeve”, është konkretizim i kapitujve të mësipërm, kalohet në metodën analitike, pasi janë hulumtuar ndërveprimet e faktorëve të ndryshëm shoqërorë, kontekstualë, historikë etj. Aty, trajtohet edhe evoluimi dhe ndryshimi i pasthirmave dhe onomatopeve në gjuhën shqipe dhe ndikimi i pashmangshëm nga gjuhët e tjera. Duke marrë si model përfaqësues komunikimin e shkruar instant dhe duke paraqitur shembuj konkretë, ne paraqesim njëkohësisht rolin e këtyre pjesëve të ligjëratës në situatë joformale dhe

dallueshmërinë mes grupeve të ndryshme shoqërore në përdorimin e tyre. Analiza e tillë, edhe pse duket e karakterit empirik, në fakt, shpreh ndryshimin thelbësor që pëson gjuha në përdorimin në internet dhe dëshmon se si ekonomizimi i gjuhës prodhon dhe shton përdorimin e pasthirmave dhe të onomatopeve. Po ashtu, një rol i veçantë u kushtohet edhe pasthirmave dhe onomatopeve që vijnë si huazim i drejtpërdrejtë nga gjuhët e tjera, për t'iu përgjigjur nevojave të shoqërisë së sotme. Përmes këtij kapitulli, më shumë sesa paraqitja dhe renditja e onomatopeve dhe pasthirmave, synohet kërkimi i modeleve dhe përmes tyre të punohet për një klasifikim të tyre. Përveç ndarjes së tyre sipas kriterit semantik të propozuar nga autorë, si Werizbicka, gjegjësisht Kortvelyessi për onomatopenë, janë analizuar edhe çështje të polisemisë, e në rastin e onomatopesë edhe çështje të një ndarjeje të re, bazuar në fusha semantike, varësisht nga burimi i prodhimit të zërit a zhurmës që imitohet a riprodhohet. Kjo ndarje domosdomërisht na çon te veçoritë fonologjike të onomatopeve që janë objekt trajtimi në **kapitullin e katërt**, ku me theks të veçantë është trajtuar lidhja e onomatopesë me simbolizimin tingullor. Ky kapitull është kapitulli më voluminoz, pasi onomatopeja para së gjithash mbështetet në tinguj dhe trajtimi i atyre tingujve nga aspekte të ndryshme është konsideruar i domosdoshëm. Në **kapitullin e pestë**, “Fjalëformimi pasthirmor e onomatopeik”, shqyrtohen mundësitë fjalëformuese të secilës prej tyre në një korpus të pakufizuar, duke parë të gjitha mënyrat e fjalëformimit dhe klasat e fjalëve që pasurohen prej temash onomatopeike e pasthirmore. Përmes kësaj analize është parë kapaciteti i tyre fjalëformues, bashkëveprimi i tyre me mjete të caktuara fjalëformuese e mënyra fjalëformimi (prejardhje, konversion etj.). **Kapitulli i gjashtë** merret me sintaksën, i trajtuar kryesisht përmes Korpusit Nacional të Shqipërisë, të marrë për analizë, me ç’rast paraqiten shembujt më domethënës të përdorimit të këtyre pjesëve të ligjëratës, të cilat, përjashtuar situatat joformale dhe letërsinë, ku gjejnë përdorim relativisht të madh, nuk gjejnë përdorim të shpeshtë në situata, regjistra e diskurse të tjera. Si rrjedhojë, rëndësi e veçantë i është kushtuar edhe trajtimit të vendit të tyre në fjali, pavarësisht sintaksore të tyre, funksioneve etj. Trajtimi i strukturës dhe funksioneve gjuhësore të pasthirmave dhe onomatopeve është thelbësor për t’i kuptuar këto pjesë të ligjëratës që edhe pse shpeshherë shfaqen nën të njëjtin klasifikim, qëndrojnë krejtësisht të ndara. Përveç në gjuhën e folur, pasthirrat dhe onomatopetë janë trajtuar edhe në gjuhën e shkruar, pra është bërë një trajtim empirik i tyre në letërsi, i përfshirë në **kapitullin e shtatë**. Trajtimi i tyre në letërsi, përveçqë i jep një dimension tjetër punimit, sjell modelin më të mirë të konkretizimit të tyre. Romani “Oh” i Anton Pashkut, i cili prej paratekstut shpërfaq në mënyrë eksplicite një pasthirmë dhe romani

“Lumi i vdekur” i Jakov Xoxës janë dy shembuj eklatantë për thellimin e kësaj analize që më shumë sesa empirike është thellim analitik dhe komparativ. Përveç këtyre dy veprave, për analizë janë marrë edhe tekste të tjera autoriale e popullore, si: romani “Kështjella” i Kadaresë, poezitë “Vdekja e Nositit” e Lasgush Poradecit, poezi nga Abetarja, kënga e Gjergj Elez Alisë, dhe duke qenë onomatopetë e pasthirmat konsiderohen si shumë të pranishme në krijimet edukative për fëmijë, kemi marrë, po ashtu, për analizë këngë për fëmijë, të tilla si “Qengji i vogël” e “Tring zilja”. Duke qenë se është e pamundur të bëhet analizë e të gjitha veprave letrare, e kemi rrudhur problemin në vetëm këto vepra kyçe, por gjithsesi analiza e tillë shpërfaq aftësinë e autorëve për përdorimin/krijimin e pasthirmave dhe onomatopeve leksikore dhe joleksikore dhe njëherësh shpërfaq funksionet stilistike të këtyre njësive leksikore në tekste letrare.

**Kapitulli i tetë**, “Ndarja e onomatopesë nga pasthirmma”, i organizuar në formë rekomandimesh, që dalin nga i gjithë hulumtimi, që është njëkohësisht edhe kapitulli përmbyllës i këtij punimi doktrate, ka për qëllim që, përmes marrjes në konsideratë të kriterëve më sinjifikante, të bëjë një sprovë për rikategorizim dhe klasifikim të onomatopeve dhe pasthirmave si pjesë të ndryshme të ligjëratës. Nëse në kapitujt e tjerë është mëtuar dokumentimi dhe komentimi i trajtesave të gjuhëtarëve të ndryshëm shqiptarë për këto pjesë të ligjëratës dhe evidentimi i problematikave e mungesave, ndër vite, të trajtimit shkencor dhe të përkufizimit të onomatopeve dhe të pasthirmave, në këtë kapitull hidhen hipoteza për një kufi ndarës ndërmjet pasthirmave dhe onomatopeve, thellohet trajtimi i tyre dhe synohet klasifikimi i onomatopeve si grup i veçantë. Kjo, konsiderojmë, do të plotësonte vakuumin studimor të deritashëm për një ndër pjesët e rëndësishme të ligjëratës, të patrajtuar sa duhet.

Në fund, është bashkëngjitur një fjalorth i të gjitha onomatopeve, pasthirmave, si dhe fjalëve të formuara nga tema fjalëformuese pasthirmore e onomatopeike.

Punimi i doktoratës *Onomatopeja dhe pasthirmma – bazat motivuese dhe roli i tyre në fjalëformimin e shqipes* synon të jetë studim që çon kah trajtesa e problemit në gjenezë, pasi vetëm duke evidencuar aspektin formues, prejardhjen dhe bashkëveprimin e onomatopeve dhe pasthirmave me pjesët e tjera të ligjëratës, arrijmë t’i kategorizojmë dhe t’u japim vendin e duhur mes pjesëve të tjera të ligjëratës.

## Résumé

The PhD thesis *Onomatopoeia and interjection - motivational bases and their role in the Albanian word formation* is an analytical, empirical and comparative study that is driven by the nature of the research of these two parts of speech, which, despite being perceived as interconnected, actually occupy entirely separate places in the discourse, perform different functions in the sentence and have different origins. The study is organized into eight chapters, starting with the general theoretical analysis; followed by the definition of onomatopoeia and interjection, the treatment of the phonetic-phonological, morphological, word-forming structure and linguistic functions; their place in literature. The last chapter makes an attempt at recategorizing onomatopoeia and interjections. The study, which employs different methods for testing the initial hypotheses, is guided by the analytical, concretizing principle and aims to reveal the use and formation of these parts of speech.

**The first chapter** discusses the historical-theoretical context, including the origin of language, language as a sign, sound imitation, the arbitrariness of the linguistic sign, and other aspects from a broad perspective. The theoretical background helps to deepen the study of onomatopoeia and exclamations, which, in Albanian linguistics, have remained as one of the most marginalized parts of speech. Following a brief review of the theoretical background, the definitions of exclamation and onomatopoeia are presented in the **second chapter**, emphasizing the similarities and differences between the two as well as their most representative features. Additionally, the theoretical study texts are examined in this chapter in order to proceed with the analysis of exclamations and onomatopoeia in Albanian linguistics, particularly in school and normative grammars. Additionally, comments on these texts are made in order to present a challenge for classifying and dividing them.

This kind of analysis serves to present the complete study panorama of these parts of speech and at the same time confronts the viewpoints of different linguists on the same phenomena and determines the further course of the work.

**The third chapter**, "Semantics of exclamations and onomatopoeia", is a concretization of the preceding chapters, it moves on to the analytical method, after analyzing the ways in which various factors such as social, contextual, historical, interact etc. There, it is also examined how

exclamations and onomatopoeia have evolved and changed in the Albanian language, as well as the inevitable influence of other languages into Albanian.

Using instant written communication as a representative model and providing concrete examples, we demonstrate both the function of these parts of speech in informal situations and the differences in their use across various social groups. Though it appears to be empirical in nature, this kind of study in fact highlights the fundamental change that language undergoes in its use on the Internet and proves how the economization of language produces and increases the use of interjections and onomatopoeia.

Also, a special role is given to interjections and onomatopoeia that come as direct borrowing from other languages, to respond to the needs of today's society. Through this chapter, more than merely presenting and ranking onomatopoeia and interjections, the aim is to search for models and work on their classification through them. Apart from the categorization based on the semantic criterion proposed by authors such as Werizbicka, namely Kortvelyessi for onomatopoeia, issues pertaining to polysemy have also been examined. In the case of onomatopoeia, issues of a new division, based on semantic fields are given, depending on the source of production of voice or noise that is imitated or reproduced. This division necessarily leads us to the phonological features of onomatopoeia that are the subject of treatment in the **fourth chapter**, where the connection of onomatopoeia with sound symbolism is treated with special emphasis. This chapter is the most voluminous chapter, given that onomatopoeia first of all relies on sounds and it is considered essential to treat those sounds from different aspects. In the **fifth chapter**, "Interjection and onomatopoeic word formation", the word formation possibilities of each of them are examined in an unlimited corpus, looking at all ways of word formation and parts of speech that are enriched by onomatopoeic and interjection themes. The analysis has revealed information about their ability to form words as well as their interaction with various word formation tools and methods (origin, conversion, etc.).

**The sixth chapter** deals with syntax, treated mainly through the National Corpus of Albanian, taken for analysis, in which case the most significant examples of the use of these parts of speech are presented, which, excluding informal situations and literature, where they are used to a greater extent, do not occur frequently in other situations, registers and discourses. As a result, special attention has been given to the treatment of their place within the sentence, their syntactic



independence, functions, etc. The treatment of the linguistic structure and functions of interjections and onomatopoeia is essential to understand these parts of speech that, despite frequently appearing under the same classification, they remain completely separate. **Chapter seven** includes an empirical examination of interjections and onomatopoeia in literature, as they have been studied in written language in addition to spoken language. Except for giving another dimension to the research at hand, their treatment in literature provides the best example of their concretization. The novels "Oh" by Anton Pashku, in which the interjection is made clear from the outset, and "Lumi i Vdekur" by Jakov Xoxa are two notable examples of the deepening of this approach, which is comparative and analytical rather than empirical.

In addition to these two works, other authorial and popular texts were also selected for analysis, such as: the novel "Kështjella" by Kadare, the poems "Vdekja e Nosit" by Lasgush Poradeci, poems from Abetarja, the song by Gjergj Elez Alia, and given that onomatopoeia and interjections are often used in educational creations for children, we have also taken for analysis songs for children, such as "Qengji i vogël" and "Tring zilja". Since it is impossible to analyze all literary works, we have narrowed the scope of this analysis to only these key works. However, such an analysis reveals the authors' ability to use/create lexical and non-lexical interjections and onomatopoeia and at the same time reveals the stylistic functions of these lexical units in literary texts.

The eighth and final chapter of this PhD thesis, "Separation of onomatopoeia from interjection," is structured as a set of recommendations based on the entire research. It attempts to categorize and classify onomatopoeia and interjections as distinct parts of speech by taking into account the most important criteria.

This chapter attempts to draw the lines between interjections and onomatopoeias, deepens their treatment, and an attempt is made to classify onomatopoeias as a separate category. On the other hand, the preceding chapters concentrated on documentation and analysis of the approaches adopted by various Albanian linguists on these parts of speech, and highlighting the problems and gaps in the definition and scientific treatment of interjections and onomatopoeia over the years.

This, we consider, would fill the research vacuum that has existed so far regarding one of the important parts of speech yet not treated sufficiently.

In the end, a glossary of all onomatopoeias, interjections, as well as words derived from interjections and onomatopoeic word-forming themes is attached.

The doctoral thesis *Onomatopoeia and interjection - motivational bases and their role in the Albanian word formation* aims to be a study that leads to the treatment of the problem in its genesis, since only by evidencing the formative aspect, the origin and interaction of onomatopoeia and interjections with other parts of speech, we manage to categorize them and give them their proper place among other parts of speech.